

## STATUTI

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "BREGASI ENTERPRISES OU"

### Përkuftizime

Në këtë statut termat :

- "Ligi" → është ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- "Statut" → është statuti "BREGASI ENTERPRISES OU" shpk
- "Ditë të plota" → në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyjnë fuqi njoftimi.

### KREU I

#### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA

##### Neni 1

##### Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më datë 15.01.2024 unë themeluesi kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin "BREGASI ENTERPRISES OU"
2. Themeluesi i shoqërisë është :

- ▶ Emër, Mbiemër : Klaus Bregasi
- ▶ Forma e shoqërisë : Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
- ▶ Emri ligjor i shoqërisë : BREGASI ENTERPRISES OU
- ▶ Adresa e shoqërisë : Rr.Frosina Plaku, Banesa nr.6, njesia administrative nr7, Tiranë
  
- ▶ Vendi rregjistrimit : TIRANË

##### Neni 2

##### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

EKSPORT- IMPORT, tregtimi me pakicë i mallrave të ndryshëm industrial etj.



**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj : Për një periudhë kohore të pakufizuar.

**Neni 4**

**Selia, Adresa e fakes së internetit dhe adresa elektronike**

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Rr.Frosina Plaku, Banesa nr.6, njesia administrative nr7, Tiranë
1. Adresa elektronike : klaus.bregasi@yahoo.com
2. Numër celulari 0698888733

**KREU II**

**KAPITALI I RREGJISTRUAR**

**Neni 5**

**Vlera dhe pagesat e kapitalit të rregjistruar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është : 1000 lekë

Pjesmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm :

- Ortaku themelues : Klaus Bregasi
- Lloji i kontributit : LEKË
- Vlera e kontributit : 1000 lekë
- Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë : 100 %

Vlera totale e kapitalit të rregjistruar është : 1000 lekë

Vlera e paguar është : 1000 lekë

2. Kapitali themeltar i shoqërisë është rregjistruar : QKB

**Neni 6**

**Llojet e kuotave, të drejtave dhe kufizimeve**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Ortakut të Vetëm.



### Neni 7

#### Kalimi i kuotave me trashëgimi ose si pasojë e falimentimit

1. Nëse Ortaku i Vetëm vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët e tij do të jenë personat e vetëm të njoftur nga shoqëria si gjëzues së të drejtave mbi kuotën e tij, pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e Ortakut të Vetëm të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm.
2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkua nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjeter të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh një person tjeter të rregjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjeter.
3. Personi tjeter që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gjëzonte zotëruesi i kuotës, duke përashtuar të drejtën e pjesmarrjes ose të votës, deri në momentin e rregjistrimit në QKB.

### Neni 8

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Shoqëria me vendim të Ortakut të Vetëm mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet edhe me qëllim, pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.
2. Shoqëria me vendim të Ortakut të Vetëm mund të zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë

### KREU III

#### ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 9

#### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- ▶ miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ▶ shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- ▶ investime;
- ▶ vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

#### Neni 10 Emërimi i administratorit

Shpk "BREGASI ENTERPRISES OU" ka si administrator të saj, Ortakun e Vetëm **Klaus Bregasi**.

Në pajtim me ligjin, neni 95, pëika 1, afati i emëritit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje duke filluar 15.01.2024-14.01.2029.

Emër, mbiemër	Adresa	Specimenti i nënshkrimit
Klaus Bregasi	Rr.Frosina Plaku, Banesa nr.6, njesia administrative nr7, Tiranë	

#### Neni 11 Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- ▶ kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- ▶ përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- ▶ kujdeset përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ▶ përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me përdorimin e fitimeve;
- ▶ krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- ▶ kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT", ndryshuar me ligjin Nr.131/2015 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT";
- ▶ kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



**KREU IV**  
**DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR**

**Neni 12**  
**Dividentët**

1. Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria mund të deklarojë shpërndarjen e dividentit.
2. Asnjë divident ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë, nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

**Neni 13**  
**Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar**

Administratori pas vendimit të marrë nga Ortaku i Vetëm dhe referuar përcaktimave të nenit 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e paspërndara, të cilët nuk do të përdoren për të paguar dividentë preferencialë, apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

**Neni 14**  
**Viti finanziar**

Viti finanziar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziarë fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

**KREU V**  
**PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**Neni 15**  
**Prishja dhe shpërndarja**

Prishja dhe shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për ç'farëdo shkaku, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar, siç mund të jenë :

- ▶ Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të veprimtarisë së saj.
- ▶ Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji Nr.8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin".



- ▶ Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

#### **Neni 16**

##### **Likujdimi**

Në rast të likujdimit të shoqërisë, Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim për emërimin e 1 ose disa likujdorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likujdim e sipër".

Afat i emërit të likujdorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës, duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Rregjistrat të Shoqërive.

Likujduesi, në përputhje me ligjin dhe me vendimin e Ortakut të Vetëm, mund të shpërndajë në dobi të ortakut të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri.

#### **Neni 17**

##### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe ç'farëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 18**

##### **Dispozita përfundimtare**

Ky statut u përpilua në (tre) 3 kopje me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, të miratuar në parim dhe nen për nen dhe nënshkruar në të gjitha kopjet, duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën e tyre origjinale.

**ORTAKU I VETËM**

*Klaus Bregzer  
KB*